VENDIM
Nr.1602, datë 10.12.2008

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, NË PRONËSI TË 4 FAMILJEVE TË FSHTRAVE ZALL-MNER DHE BULÇESH, TË PREKURA NGA NDËRTIMI I UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, në pronësi të 4 familjeve të fshatrave Zall-Mner dhe Bulçesh, të prekura nga ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, për sipërfaqen 29 710 (njëzet e nëntë mijë e shtatëqind e dhjetë) m^2, tokë arë, të vlerësuar me çmimin 626 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë) lekë/m^2, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 18 598 460 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë.

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 235 000 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 18 598 460 (tetëmbëdhjetë milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë "Fondi i shpronësimeve", të parashikuar për shpronësimin e unazës Shkodër.

5. Procedurat e likuidimit të përfundojnë brenda datës 31.12.2008.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E 4 FAMILJEVE TË FSHATRAVE ZALL-MNER DHE BULÇESH, TË CILAT KOMPENSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË UJËMBLEDHËSIT TË BOVILLËS

Nr.	Pronari			Sip. tokë arë	Çmimi	Vlera lekë	Fshati
	Emri	Atësia	Mbiemri				
1	Baftjar	Ramazan	Ademi	7360	626	4607360	ZALL-MNER
2	Ramazan	Asllan	Ruçi	5400	626	3380400	ZALL-MNER
3	Xhemal	Hider	Cali	10070	626	6303820	BULÇESH
4	Besim	Aruç	Hoxha	6880	626	4306880	BULÇESH
		TOTALI		29710		18598460	